

Platforma për të Drejtat e Njeriut

Constitutional Articles: E Drejta e Privatësisë

1. Çdokush gëzon të drejtën që t'i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera.
2. Kontrollat e cilësdo banese ose cilitdo objekti privat, që mendohet se janë të domosdoshme për hetimin e krimit, mund të bëhen vetëm deri në shkallën e domosdoshme dhe vetëm pas miratimit nga ana e gjykatës, pas shpjegimit të arsyeve pse një kontroll i tillë është i domosdoshëm. Shmangia nga kjo rregull lejohet, nëse është domosdoshme për arrestim të ligjshëm, për mbledhjen e provave që ka rrezik të humbasin ose për menjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për njerëzit dhe për pasuri, në mënyrën e përcaktuar me ligj. Gjykata duhet që të miratojë veprimet e tilla në mënyrë retroaktive.
3. Fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimit tjetër, është e drejtë e pacenueshme. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm përkohësisht, në bazë të vendimit gjyqësor, nëse është e domosdoshme për ecurinë e procedurës penale ose për mbrojtjen e vendit, në mënyrën e parashikuar me ligj.
4. Secili person gëzon të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale. Mbledhja, ruajtja, qasja, korrigjimi dhe shfrytëzimi i tyre rregullohet me ligj.

Constitutional Paragraph: Neni 36 para 1

1. Çdokush gëzon të drejtën që t'i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera.

Instrumentet ndërkombëtare Nenet

Neni 17.1

Pakti Nderkombëtar për të
Drejtat civile dhe Politike
Pakti Nderkombëtar për të
Drejtat civile dhe Politike

1. Askush nuk duhet t'jet objekt i ndërrhyrjeve arbitrare ose t'paligjshme në jetën e tij private, në familje, në shtëpi ose letërkëmbim, e as duhet t'i shkelet nderi dhe reputacioni i tij në mënyrë t'paligjshme.

Instrumentet ndërkombëtare Nenet

Konventa Evropiane për
Mbrojtjen e të Drejtave dhe
Lirive Themelore të Njeriut
dhe Protokollet e saj

Neni 8.1

1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

Konventa Evropiane për
Mbrojtjen e të Drejtave dhe
Lirive Themelore të Njeriut
dhe Protokollet e saj

Neni 8.2

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve

Deklarata Universale për të
Drejtat e Njeriut
Deklarata Universale për të
Drejtat e Njeriut

Neni 12.

Asnjëri nuk duhet t'i nënshtrohet ndërhyrjes arbitrare në jetën, familjen, banesën ose korrespondencën vetjake, si dhe sulmeve kundër nderit dhe prestigjit personal. Gjithkush ka të drejtën të mbrohet nga ligji kundër ndërhyrjeve ose sulmeve të tilla.

Neni 16

Konventa për të Drejtat e
Fëmijës
Konventa për të Drejtat e
Fëmijës

1. Asnjë fëmijë nuk u nënshtrohet ndërhyrjeve arbitrare ose të paligjshme në jetën e tij private, në familje, në shtëpi ose në korrespondencën e tij, as cënimeve të kundërligjshme të nderit dhe reputacionit të tij.

2. Fëmija ka të drejtën e mbrojtjes me ligj kundër ndërhyrjeve ose cënimeve të tilla.

Neni 22

Respekti për jetën private (privacia)

Konventa për të Drejtat e
Personave me Aftësi të
Kufizuar dhe Protokoll
Opsional
Konventa për të Drejtat e
Personave me Aftësi të
Kufizuar dhe Protokoll
Opsional

1. Asnjë person me aftësi të kufizuar, pavarësisht nga vendbanimi apo mënyra e jetesës nuk duhet bëhet objekt i ndërhyrjeve arbitrare apo të paligjshme në jetën e tij/saj private, në familje, në lidhje me korrespondencën, llojet e tjera të komunikimit apo të bëhet objekt i sulmeve të paligjshme ndaj nderit apo reputacionit të tij/saj. Personat me aftësi të kufizuar kanë të drejtën për mbrojtje ligjore ndaj këtyre ndërhyrjeve dhe sulmeve.

2. Shtetet Palë do të mbrojnë privacinë e informacionit personal, shëndetësor dhe në lidhje me statusin e rehabilitimit të personave me aftësi të kufizuar, njësoj si pjesa tjetër e popullësisë.

Neni 197

Cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve

KODI NR. 06/L-074
KODI PENAL I
REPUBLIKËS SË
KOSOVËS
KODI NR. 06/L-074
KODI PENAL I
REPUBLIKËS SË
KOSOVËS

1. Kushdo që pa autorizim apo në mënyrë të kundërligjshme hyn në banesë ose në objektin e mbyllur të personit tjetër apo nuk largohet nga objektet e tilla sipas kërkesës së personit të autorizuar, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet.
2. Tentativa për të kryer veprën penale nga paragrafi 1. i këtij neni është e dënueshme.
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga personi zyrtar në keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Neni 198

Kontrollimi i kundërligjshëm

KODI NR. 06/L-074
KODI PENAL I
REPUBLIKËS SË
KOSOVËS
KODI NR. 06/L-074
KODI PENAL I
REPUBLIKËS SË
KOSOVËS

1. Personi zyrtar i cili me keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij bën kontrollim të kundërligjshëm të banesës, objekteve apo personit, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në (3) tre vjet.
2. Për qëllime të këtij neni, objektet përfshijnë, por nuk kufizohen në banesën dhe kopshtin rrethues, biznesin, zyrën, dhomën e hotelit apo dhomën e marrë me qira.

Neni 199

Cenimi i fshehtësisë së korrespondencës dhe i bazave të të dhënave kompjuterike

KODI NR. 06/L-074
KODI PENAL I
REPUBLIKËS SË
KOSOVËS
KODI NR. 06/L-074
KODI PENAL I
REPUBLIKËS SË
KOSOVËS

1. Kushdo që pa autorizim e hap letrën, telegramin, faksimilin apo ndonjë dokument tjetër të mbyllur ose dërgesë apo komunikim elektronik të personit tjetër, ose në ndonjë mënyrë tjetër e cenon fshehtësinë e materialeve të tilla apo pa autorizim mban, fsheh, asgjëson ose i dorëzon personit tjetër letrën, telegramin, faksimilin, komunikimin elektronik apo ndonjë dokument tjetër të mbyllur ose dërgesë të personit tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në gjashtë (6) muaj.
2. Kushdo që pa autorizim ndërhyt në bazën e të dhënave kompjuterike të personit tjetër ose ato të dhëna i shfrytëzon apo ia vë në dispozicion personit tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në një (1) vjet.

Neni 200

KODI NR. 06/L-074
KODI PENAL I
REPUBLIKËS SË
KOSOVËS
KODI NR. 06/L-074
KODI PENAL I
REPUBLIKËS SË
KOSOVËS

Zbulimi i paautorizuar i informacionit konfidencial

1. Avokati, mbrojtësi, mjeku apo personi tjetër i cili pa autorizim zbulon informacionin konfidencial për të cilin është vënë në dijeni gjatë ushtrimit të profesionit të vet dhe që është ligjërisht i detyruar ta mbajë në fshehtësi, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.
2. Personi nuk është penalisht përgjegjës sipas paragrafit 1. të këtij neni nëse e ka zbuluar informacionin konfidencial për interes publik nëse interesi i tillë peshon më shumë se mos zbulimi i informatës së fshehtë.

KODI NR. 06/L-074
KODI PENAL I
REPUBLIKËS SË
KOSOVËS
KODI NR. 06/L-074
KODI PENAL I
REPUBLIKËS SË
KOSOVËS

Neni 201

Përgjimi i paautorizuar

1. Kushdo që pa autorizim, përgjon bisedën apo deklaratën ose i mundëson personit tjetër të jetë në dijeni për bisedën apo deklaratën e cila është përgjuar pa autorizim, dënohet me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.

Neni 202

Fotografimi dhe incizimet tjera të paautorizuara

KODI NR. 06/L-074
KODI PENAL I
REPUBLIKËS SË
KOSOVËS
KODI NR. 06/L-074
KODI PENAL I
REPUBLIKËS SË
KOSOVËS

1. Kushdo që pa autorizim fotografon, filmon, incizon me video ose në ndonjë mënyrë tjetër incizon personin tjetër në banesën e tij personale ose në ndonjë vend tjetër ku personi ka pritje të arsyeshme për privatësi dhe në këtë mënyrë thelbësisht cenon privatësinë e tjetrit, dënohet me gjobë ose me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.
2. Kushdo që pa autorizim ia kalon, shfaq apo i jep qasje personit të tretë në fotografinë, filmin, videokasetën apo ndonjë incizim tjetër të marrë në shkelje të paragrafit të këtij neni, dënohet me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.

Neni 1

Qëllimi

Ligji nr. 06/l-082 për mbrojtjen e të dhënave personale
Ligji nr. 06/l-082 për mbrojtjen e të dhënave personale

1. Ky ligj përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit. Përmes këtij ligji përcaktohen përgjegjësitë e institucionit përgjegjës për mbikëqyrjen e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave dhe qasjes në dokumente publike.
2. Ky ligj është në përputhje me Rregulloren (BE) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës, 27 prill 2016, për mbrojtjen e personave fizik sa i përket përpunimit të të dhënave personale dhe qarkullimit të lirë të këtyre të dhënave, që shfuqizon Direktivën 95/46/ EC (Rregullorja për mbrojtjen e të dhënave të përgjithshme)“.

Neni 4

Parimet e përpunimit të të dhënave personale

1. Parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës - të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme, të ligjshme dhe transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave.
2. Parimi i kufizimit të qëllimit – të dhënat personale grumbullohen vetëm për qëllime të caktuara, të qarta dhe legjitime dhe nuk mund të përpunohen më tutje në kundërshtim me këto qëllime. Përpunimi i mëtejshëm me qëllim të arkivimit për interes publik, qëllimit të hulumtimit shkencor ose historik, ose qëllimit statistikor, nuk konsiderohet që është në mospërputhje me qëllimin fillestar.
3. Parimi i minimizimit të të dhënave – të dhënat personale duhet të jenë adekuate, relevante dhe nuk duhet t'i tejkalojnë qëllimet për të cilat ato janë grumbulluar ose përpunuar më tutje.
4. Parimi i saktësisë – të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe të përditësuara. Duhet të merret çdo hap i arsyeshëm për të garantuar që të dhënat personale që janë të pasakta, duke pasur parasysh qëllimin e përpunimit, të fshihen dhe të korrigjohen pa vonesë.
5. Parimi i kufizimit të ruajtjes – të dhënat personale mund të ruhen vetëm për atë kohë sa është e nevojshme për arritjen e qëllimit, për të cilin janë grumbulluar ose përpunuar më tutje. Me rastin e përmbytjes së qëllimit të përpunimit, të dhënat personale asgjësohen, fshihen, shkatërrohen, bllokohen ose bëhen anonime, përveç nëse është paraparë ndryshe me Ligjin përkatës për Arkivat Shtetërore ose me ndonjë ligj tjetër përkatës.
6. Parimi i paprekshmërisë dhe konfidencialitetit – të dhënat personale përpunohen në atë mënyrë që garantojnë siguri të përshtatshme të tyre, duke përfshirë mbrojtjen ndaj përpunimit të paautorizuar ose të paligjshëm dhe ndaj humbjes, asgjësimit ose dëmtimit aksidental, duke përdorur masa të përshtatshme teknike dhe organizative.
7. Parimi i llogaridhënies – kontrolluesi duhet të jetë përgjegjës dhe në gjendje të zbatojë përputhshmërinë e të gjitha parimeve të përcaktuara me këtë nen.

Neni 4.1

Karakteri personal i të dhënave

1. Të dhënat, individuale e familjare, të përbërësve të gjendjes civile kanë karakter personal. Aktet, të dhënat dhe konfirmimet shkresore për gjendjen civile i jepen vetëm personit, që i përkasin këto të dhëna, anëtarit të familjes, kujdestarit, përfaqësuesit ligjor ose, me prokurë dhe pas vdekjes, atyre, që kanë legjitimitetin e kërkimit të trashëgimisë ligjore ose trashëgimtarëve testamentarë.

Ligji nr. 06/1-082 për mbrojtjen e të dhënave personale
Ligji nr. 06/1-082 për mbrojtjen e të dhënave personale

LIGJI Nr. 04/L-003 PËR GJENDJEN CIVILE
LIGJI Nr. 04/L-003 PËR GJENDJEN CIVILE

Neni 7.1

LIGJI Nr. 04/L-003 PËR
GJENDJEN CIVILE

Mbrojtja e të drejtave

LIGJI Nr. 04/L-003 PËR
GJENDJEN CIVILE

1. Mbrojtja e të drejtave dhe interesave të personave që u regjistruan të dhënat, e drejta e qasjes në regjistra dhe korrigjimi i të dhënave bëhet në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 4.2

LIGJI NR. 06/L-038 PËR
SHËRBIMET POSTARE
LIGJI NR. 06/L-038 PËR
SHËRBIMET POSTARE

2. Ofrimi i shërbimeve postare duhet të garantojë fshehtësinë e korrespondencës dhe mbrojtjen e të dhënave personale, vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve universale postare, mbrojtjen e interesave të shfrytëzuesve dhe sigurimin e trajtimit të barabartë të tyre sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 2

LIGJI Nr. 04/L-109 PËR
KOMUNIKIMET
ELEKTRONIKE
LIGJI Nr. 04/L-109 PËR
KOMUNIKIMET
ELEKTRONIKE

Ky ligj rregullon marrëdhëniet shoqërore që kanë të bëjnë me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, shërbimet dhe facilitetet shoqërore, përdorimin e resurseve të komunikimeve elektronike, si dhe marrëdhënieve shoqërore që kanë të bëjnë me radio-pajisjet, pajisjet fundore dhe përputhshmërinë elektromagnetike, siguron nivel të barabartë të mbrojtjes së të drejtave për të dhënat personale, **veçanërisht të drejtën e privatësisë së procesimit të të dhënave personale në sektorin e komunikimeve elektronike.**

decisionTitle*

decisionDescription*

Christine Goodwin
kundër Mbretërisë
së Bashkuar
(ankesa nr.
28957/95), 11
korrik 2002

1. Faktet kryesore Ankuesi, Christine Goodwin, një shtetase e Mbretërisë së Bashkuar, e lindur në vitin 1937, është një transeksual mashkull i kthyer në femër. Ankuesi pretendonte se kishte probleme dhe përballje me ngacmime seksuale në punë gjatë dhe pas ndryshimit të gjinisë së saj. Kohët e fundit, ajo përjetonte vështirësi në lidhje me kontributet e sigurimit të saj kombëtar (NI). Duke qenë se ligjërisht ajo figuron ende si burrë, ajo duhet të vazhdojë të paguajë kontribute NI deri në moshën 65 vjeç. Në qoftë se ajo do të njihej si grua, ajo do të pushonte së paguari kontribute të tilla në moshën 60 vjeç, në prill 1997. Asaj i është dashur të bëjë rregullime të veçanta për të vazhduar pagesën e kontributeve të saj NI direkt vetë për të shmangur pyetjet e ngritura nga punëdhënësit e saj në lidhje me anomalinë. Ajo gjithashtu pohoi se fakti që ajo mban të njëjtin numër të NI do të thotë se punëdhënësi i saj ka qenë në gjendje të zbulonte se më parë ajo kishte punuar për ta nën një emër dhe gjini tjetër, gjë kjo që kishte rezultuar në vështirësi dhe poshtërim.

Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut vendosi unanimisht se:

Ka patur një shkelje të Nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) e Konventës Europiane mbi të Drejtat e Njeriut;

Ka patur një shkelje të Nenit 12 (e drejta për t'u martuar dhe krijuar familjen);

decisionTitle***decisionDescription***

SLIVENKO kundër
LETONISË
(kërkesa nr.
48321/99) 9 tetor
2003

Gjykata vuri re se Tatjana Slivenko kishte shkuar në Letoni kur ajo kishte qenë veçse një muaj dhe kishte jetuar atje deri në moshën 40 vjeçare. Në Letoni ajo kishte shkuar në shkollë, kishte punuar dhe ishte martuar. E bija, Karina kishte lindur në Letoni dhe kishte jetuar atje deri në moshën 18 vjeç, pasi kishte përfunduar shkollën e mesme. Për këto arsye, që nga lindja e tyre ato kishin zhvilluar një rrjet marrëdhëniesh personale, sociale dhe ekonomike, të cilat janë përbërës të një jete private në Letoni. Ato humbën gjithashtu një apartament në Letoni, në të cilin ato edhe kishin banuar. **Për këto arsye largimi i tyre nga Letonia përbënte një ndërhyrje ndaj së drejtës së tyre për jetë private dhe banesë.**

Vendimi i Gjykatës. Në lidhje me nenin 8 KENDJ, Dhoma e Madhe vlerëson se largimi i kërkuar nga Letonia shkelte të drejtat e tyre për jetë private

MALONE v. THE
UNITED
KINGDOM
(Application no.
8691/79) of 2
August 1984

Aplikanti pretendoi shkelje të këtij neni (neni 8) nën dy paradrafet. Në parashtresën e tij, shkelja e parë rezultoi nga përgjimi i postës dhe i telefonit të tij nga ose në emër të policies,

Gjykata ka konstatuar njëzëri se ka pasur shkelje të nenit 8 (neni 8) të Konventës;

DADOUCH kundër MALTËS (Kërkesa nr.3816 / 07) 20 korrik 2010

DADOUCH kundër
MALTËS (Kërkesa
nr.3816 / 07) 20
korrik 2010

Kërkuesi u ankua se refuzimi për të regjistruar martesën e tij bazuar në një kërkesë për letër të kombësisë ishte një ndërhyrje që nuk ishte në përputhje me ligjin dhe nuk ishte e domosdoshme në një shoqëri demokratike dhe prandaj duke shkelur nenin 8 të Konventës

Gjykata konsideron se ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës;

decisionTitle***decisionDescription***

GILLOW v. THE UNITED KINGDOM (*Application no. [9063/80](#)*) 24 November 1986

GILLOW v. THE
UNITED
KINGDOM
(Application no.
9063/80) 24
November 1986

Ankesa kryesore e ankuesve ishte drejtuar kundër Ligjeve të Strehimit të Guernsey dhe veprimi i tyre në rastin e tyre të veçantë, të cilin ata e parashtruan i kishin privuar nga të drejtat e tyre të banimit. Kjo ankesë u shoqërua me pretendimin se ligjet e përmendura ishin "legjislacion zëvendësues i emigracionit" dhe për këtë arsye të pavlefshme me kushtetutën. Guernsey nuk kishte juridiksion për të nxjerrë ligje mbi çështjet e emigracionit dhe nacionalitetit. Aplikantët gjithashtu pohuan se procedura e ndjekur në lidhje me ankesën kundër refuzimit të licencave për të zënë shtëpinë e tyre "Whiteknights" dhe me ndjekjen e tyre pasuese për okupim të paligjshëm ishte i padrejtë dhe ishte kryer nën një sistem arkaik ligjor dhe gjyqësor që nuk kishte pavarësi. Ata u mbështetën, ndër të tjera, në nenet 6, 8, 14 dhe 18 të Konventes.

Sipas ankuesve, ata kishin krijuar "Whiteknights" si shtëpinë e tyre në vitin 1958. Edhe pse ata më pas kishin lënë Guernsey, ata kishin ruajtur pronësinë e shtëpisë, për të cilën ata gjithmonë kishin për qëllim të ktheheshin dhe kishin mbajtur mobiljet e tyre në të. Me kthimin e tyre në vitin 1979, ata jetonin në pronë me qëllim të marrjes së vendbanimit të përhershëm sapo të përfundoheshin negociatat me Autoritetin e Strehimit lidhur me statusin e tyre të banimit dhe u kryer riparimet e nevojshme.

Gjykata vendosi:

1. Se **nuk ka pasur** shkelje të nenit 8 të Konventës sa i përket kushteve të legjislacionit të kontestuar;
2. Se **ka pasur** shkelje të nenit 8 (neni 8) i Konventës sa i përket zbatimit të legjislacionit të kontestuar në rastin e aplikantëve

CAMPBELL v. THE UNITED KINGDOM (*Application no. [13590/88](#)*) 25 March 1992

CAMPBELL v.
THE UNITED
KINGDOM
(Application no.
13590/88) 25
March 1992

Z. Campbell paraqiti kërkesën e tij në Komision më 14 janar 1986. Ai u ankua për ndërhyrjen e autoriteteve të burgut me korrespondencën e tij me avokatin e tij, Komisionin dhe një deputet në kundërshtim me nenin 8. Ankuesi u ankua se korrespondenca nga avokati i tij dhe Komisioni u hap dhe u lexua nga autoritetet e burgjeve.

Gjykata vendosi:

1. Që ndërhyrja në korrespondencën e aplikantit me avokatin e tij **ka shkaktuar shkelje të nenit 8**
2. Që ndërhyrja në korrespondencën e aplikantit me Komisionin e **ka shkaktuar shkelje të nenit 8**

decisionTitle*

decisionDescription*

GOLDER v. THE UNITED KINGDOM (*Application no. [4451/70](#)*) 21 February 1975

GOLDER v. THE
UNITED
KINGDOM
(Application no.
4451/70) 21
February 1975

Çështja e Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar kishte të bënte me një të burgosur të cilit i ishte refuzuar leja për të kontaktuar me avokatin e t? për të paraqitur çështjen e t? civile për shpi e kundër një ofi ceri burgu. Gjykata u shpreh se kjo ishte shkelje e Nenit 6 – e **drejta për akses në gjykatë** nuk duhet vetëm të ekzistojë, por duhet të jetë gjithashtu efektive. Gjykata u shpreh gjithashtu se pamundësia e një të burgosuri për të patur konsultime konfi denciale përveç seancës gjyqësore me një avokat e privonte atë nga e drejta për akses në gjykatë.

Njëkohësisht edhe refuzimi i i petitionit të aplikantit nga ana sekretarit për ta kontaktuar avokatin e tij, poashtu pati shkelje "**të drejtës për respektimin e korrespondencës**", e garantuar me nenin 8 të Konventës.

Gjykata vendosi:

- 1. Se ka pasur shkelje të nenit 6 paragrafi 1.**
- 2. Se ka pasur shkelje të nenit 8.**